


GUIDË MBI EKONOMINË QARKULLUESE NË SHQIPËRI

Forumi Shqiptar Social
Ekonomik (ASET)



GUIDË MBI EKONOMINË QARKULLUESE NË SHQIPËRI

Forumi Shqiptar Social Ekonomik (ASET)

Rr. e Dibrës, Pall. 487, Tiranë,
E-mail info@aset-al.com
Faqja e internetit: www.aset-al.com

Kjo guidë është punuar nga Prof. Dr. Fatmir MEMAJ dhe Brunilda KOSTA

pörmboajta

6	HYRJE
8	PËRKUFIZIME MBI EKONOMINË QARKULLUESE
10	NGA EKONOMIA LINEARE NË EKONOMI QARKULLUESE
14	SFIDAT DHE AVANTAZHET E EKONOMISË QARKULLUESE
16	VENDE AVANGARDË NË EKONOMINË QARKULLUESE
20	SITUATA E EKONOMISË QARKULLUESE NË SHQIPËRI
26	RASTET E APLIKIMIT TË EKONOMISË QARKULLUESE NË SHQIPËRI
26	RASTI 1: I.N.C.A. NORDFISH SH.P.K
28	RASTI 2: ALBKALUSYAN SHPK
30	RASTI 3: AIBA COMPANY SH.A
32	RASTI 4: IB RECYCLING DHE GER.ARD. SHPK.
34	RASTI 5: PASTRIMI DETAR SHPK
36	RASTI 6: SAPUN ORGANIK I ROSKOVECIT
39	BIBLIOGRAFIA

HYRJE

Studimet parashikojnë një rritje të shpejtë të numrit të popullsisë globale në 9 miliardë në vitin 2030, ku 30% e kësaj popullsie do të përbëhet nga klasa e mesme (Brookings Institution, 2017). Ky parashikim krijon probleme që lidhen me aftësinë për të përmbushur kërkesat për produkte dhe shërbime. Paralelisht me rritjen e popullsisë, parashikohet një rritje e mbetjeve urbane me 70% në vitin 2050, krahasuar me vitin 2016 (Banka Botërore, 2017).

Sipas fondacionit Ellen MacArthur, vetëm në sektorin e mallrave të konsumit rreth 80% e vlerës së tyre humbasin në mënyrë të pakthyeshme çdo vit. Modeli linear i të bërit biznes (mer-prodho-hidh) nuk është më i përshtatshëm, duke konsideruar një serë sfidash dhe trendesh (rritja e shpejtë e popullsisë, burimet e kufizuara, urbanizimi, etj.). Megjithatë, zhvillim pozitiv është fakti që ky model ka nxitur zhvillimin e një tjetër modeli i cili njihet si “ekonomia qarkulluese” e cila ka si qëllim mirë-manaxhimin e materialeve duke i projektuar produktet dhe shërbimet në mënyrë të tillë që lejon ri-përdorimin e tyre për një kohë sa më të gjatë. Në thelb, ekonomia qarkulluese synon kalimin nga sistemi i gjenerimit të humbjeve në përdorimin/ripërdorimin sa më shumë të jetë e mundur të produkteve. Një model i tillë krijon shanse për bizneset dhe në të njëjtën kohë ndikon pozitivisht në mjedis si dhe nxit zhvillimin dhe rritjen e ekonomisë.

Kjo guidë ka si qëllim që të japë një përshkrim të konceptit të ekonomisë qarkulluese, shtetet më të zhvilluara të cilët kanë zbatuar një model të tillë si dhe situatën aktuale në Shqipëri, duke theksuar disa nga rastet pozitive që tregojnë dhe përpjekjet e para të suksesshme.

Më konkretisht, pjesa e parë paraqet përkufizime të ndryshme mbi ekonominë qarkulluese. Pjesa e dytë shpjegon tranzicionin nga një ekonomi lineare në atë qarkulluese, duke vënë theksin në përfitimet që sjell një model i tillë. Pjesa e tretë përshkruan shkurtimisht vendet që janë avangardë në zbatimin e modelit të ekonomisë qarkulluese. Pjesa e katërt përmbledh situatën e ekonomisë qarkulluese në Shqipëri dhe pjesa e pestë paraqet disa nga rastet e suksesit të zbatimit të modelit të ekonomisë qarkulluese në Shqipëri.

PËRKUFIZIME MBI EKONOMINË QARKULLUESE

Për herë të parë, ekonomia qarkulluese është përcaktuar në vitin 1990 nga Pearce dhe Turner. Në një periudhë të mëvonshme, koncepti mori një vëmendje gjithnjë e më të madhe dhe kjo u reflektua edhe në përkufizimet e ndryshme dhe të shumta të dhëna nga studiues të ndryshëm.

Sauvé et al. (2016), sugjerojnë që "ekonomia qarkulluese i referohet prodhimit dhe konsumit të mallrave përmes mbylljes së ciklit të flukseve të materialeve, duke minimizuar kështu ndikimet negative në mjedisin e jashtëm".

Një nga përkufizimet më të cituara është ai i dhënë nga Fondacioni Ellen MacArthur. Sipas tij, ekonomia qarkulluese është "një sistem industrial i cili është rigjenerues. Ai zëvendëson konceptin "fundi i jetës" me restaurimin, zhvendosjet drejt përdorimit të energjisë së rinovueshme, eliminon përdorimin e kimikateve toksike, të cilat dëmtojnë ripërdorimin, dhe synon eliminimin e mbeturinave përmes projektimit të materialeve, produkteve, sistemeve dhe modeleve të biznesit."

Komisioni Evropian (2015) ka përfshirë një përshkrim të konceptit në Komunikimin e tij "Një Plan veprimi i BE-së për ekonominë qarkulluese", i cili është pjesë e Paketës së Ekonomisë Qarkulluese. Në mënyrë të veçantë, ekonomia qarkulluese përshkruhet si një ekonomi "ku vlera e produkteve, materialeve dhe burimeve mbahet në ekonomi për aq kohë sa të jetë e mundur, dhe gjenerimi i humbjeve minimizohet".

EEA (2014) thekson se:

“Ekonomia qarkulluese përqendrohet në riciklimin, minimizimin e burimeve të përdorura, ripërdorimin e inputeve fizike dhe përdorimin e mbetjeve si burim që çon në uljen e konsumit të burimeve kryesore.”

NGA EKONOMIA LINEARE NË EKONOMI QARKULLUESE

Modeli linear ekonomik shoqërohet me një serë pikash të dobëta që diskutohen në kuadër të kostove që ky model ka prodhuar. Së pari, e analizuar në terma statistikore, 21 miliard ton e të gjitha materialeve që përdoren për të prodhuar produktet përfundimtare, humbasin gjatë procesit të prodhimit (skarco, efencë e ulët, magazinim jo i duhur, etj.) (Ellen MacArthur, 2013). Së dyti, të dhënat nga Eurostat tregojnë për një humbje rreth 2.7 miliard ton nga 65 miliard që shënoi totali i inputeve të përdorura në Europë në vitin 2010, në formën e mbetjeve (Eurostat, 2013). Nga kjo sasi e humbur, më pak se 40% u riciklua apo u ripërdor në forma të tjera. Pra, 60% e sasisë së mbetjeve nuk u përdor asnjëherë. Kjo tregon për një keqmenaxhim të burimeve që sjell ndikime të tjera negative.

wwPavarësisht të gjitha kostove që shoqërojnë ekonominë lineare, përsëri ajo ka patur pikat e saj të forta, kryesisht deri në fund të shekullit të 20-të. Megjithatë sot, pikat e dobëta të një ekonomie të tillë tejkalojnë anët pozitive dhe kjo nxiti zhvillimin e ekonomisë qarkulluese.

Përdorimi i ekonomisë qarkulluese shoqërohet me shumë përfitime. Së pari, ka një reduktim të ndikimit negativ në mjedis. Së dyti, rritja e efencës në përdorimin e burimeve, i siguron kompanive një performancë më të lartë financiare. Së treti, një model i tillë biznesi nxit konkurrueshmërinë dhe si rezultat edhe zhvillimin e metodave më inovative të prodhimit. Së katërti, krijon mundësinë e hapjes së vendeve të reja të punës duke rritur në këtë mënyrë normën e punësimit si dhe nxit rritjen ekonomike.

Në këtë kontekst, BE ka parashikur hapjen e 170,000 vendeve të reja të punës deri në vitin 2035, si rezultat i draftit të paketës së ekonomisë qarkulluese. Një paketë e tillë parashikon gjithashtu reduktimin e emetimeve të karbonit në vendet e BE-së me 450 milion ton deri në vitin 2030.

Ekonomia qarkulluese, ndryshe nga ekonomia lineare, ka një mënyrë ciklike funksionimi, të paraqitur në Figurën 1. Në një ekonomi qarkulluese, kompanitë duhet që të projektojnë produktet e tyre në një mënyrë të tillë që ato të kenë mundësi të ripërdoren sa më shumë që të jetë e mundur. Ekonomia qarkulluese funksionon mbi bazën e tri parimeve kryesore: Ruajtja dhe forcimi i kapitalit natyror; Optimizimi i produktivitetit të burimeve; Rritja e efektivitetit të sistemit. Këto tre parime mund të përkthehen në gjashtë aksione që ndërmerren nga bizneset: Rigjenero, Ndaj, Optimizo, Riciklo, Virtualizo dhe Shkëmbe. Këto përbëjnë së bashku atë që quhet korniza ReSOLVE.

EKONOMIA E GJELBËR

Në literaturën e sotme, termi ekonomi e gjelbër përdoret për atë formë të ekonomisë që ka në bazë zvogëlimin e problemeve mjedisore dhe që synon zhvillimin e qëndrueshëm pa degraduar mjedisin. Një tipar që e dallon atë nga regjimet e mëparshme ekonomike është vlerësimi i drejtpërdrejtë i kapitalit natyror dhe shërbimeve ekologjike si vlerë ekonomike. Aktualisht në shumë degë të industrisë janë intensifikuar tendencat për të zbatuar këto standarde si një mënyrë efikase për të promovuar praktikatat e gjelbëra në ekonominë globale.

EKONOMIA QARKULLUESE

Ekonomia qarkulluese është një sistem ekonomik që synon minimizimin e mbeturinave dhe shfrytëzimin më intensiv dhe eksensiv të burimeve. Në sistemin e ekonomisë qarkulluese inputi i burimeve dhe mbeturinat minimizohen duke i përdorur më me efikasitet. Kjo gjë arrihet përmes modelimit, mirëmbajtjes, riparimit, ripërdorimit, rindërtimit, rinovimit dhe riciklimit të zgjatur, gjë që është në kontrast me ekonominë tradicionale lineare. Modelet e ekonomisë qarkulluese të biznesit mund të jenë po aq fitimprurëse sa modelet lineare, duke i lejuar konsumatorët të vazhdojnë të kenë produkte dhe shërbime të ngjashme madje edhe më të mira se më parë.

1. Rrit kapitalin natyror duke kontrolluar burimet e kushtëzuara dhe duke balancuar fluksin e burimeve të ripërsëritshme

2. Optimizon rendimentin e burimeve duke rritur shkallën e qarkullimit të materialeve dhe produkteve, si në ciklin teknik ashtu edhe atë biologjik.

3. Nxit përmirësimin e efektivitetit të sistemit nëpërmjet identifikimit të ekstrernaliteteve negative




Figura 1: Mënyra e funksionimi të ekonomisë qarkulluese
Burimi: Përshtatur nga Fondacioni Ellen MacArthur

SFIDAT & AVANTAZHET E EKONOMISË QARKULLUESE

Kalimi nga ekonomia lineare në ekonominë qarkulluese, sjell shumë përfitime që lidhen me krijimin e një ekonomie inovative, të qendrueshme dhe produktive. Të përmbledhura, disa nga përfitimet përfshijnë:

Kursime të konsiderueshme të materialeve dhe ulje e ekspozimit ndaj paqendrueshmërisë së çmimeve: Fondacioni Ellen MacArthur ka vlerësuar që, në industrinë e produkteve komplekse me jetëgjatësi të mesme, ekonomia qarkulluese paraqet kursime të kostove të materialeve me rreth 630 miliard dollarë në vit (skenar i BE); në mallrat e shpejtë të konsumit në nivelin global kursimet e materialeve mund të arrijnë në 700 miliard dollar në vit.

Rritja e inovacionit dhe potencialit për krijimin e vendeve të punës: Ekonomia qarkulluese nxit mendimin krijues në zgjidhjen e problemeve, duke krijuar kështu mundësi për inovacion. Gjithashtu, parashikimet kanë vlerësuar që ekonomia qarkulluese krijon vende të reja pune.

Rritje e qendrueshmërisë: Ekonomia qarkulluese, duke lëvizur shumë më tepër materiale biologjike përmes procesit të tretjes dhe kthimit përsëri në tokë, do të zvogëlojë nevojën për rimbushje me lëndë ushqyese shtesë. Ky është parimi i rigjenerimit në punë.

Përveç përfitimeve të listuara më lart, ekonomia qarkulluese krijon mundësi të rritjes ekonomike, krijon vende të reja pune si dhe zvogëlon ndikimin në mjedis.

Pavarësisht gjithë përfitimeve që sjell zbatimi i ekonomisë qarkulluese, kalimi nga një ekonomi lineare në atë qarkulluese përballlet me një sërë sfidash.

Së pari, sfidat në nivel biznesi:

Kosto të larta: Financimi i modeleve të reja të biznesit e bën tepër të kushtueshëm gjithë procesin e transformimit drejt një modeli biznesi të ekonomisë qarkulluese.

Rezistenca ndaj ndryshimit: Kulturat statike dhe konservatore e biznesit pengojnë transformimin e biznesit, duke kufizuar angazhimin në modelin e ekonomisë qarkulluese. Modelet ekzistuese të biznesit mund të mos jenë aspak të orientuara drejt ekonomisë qarkulluese dhe për këtë arsye do të duhet që biznesi të ndërmarrë ndryshime në terma afatgjatë.

Perceptimi për një mungesë të kërkesës konsumatore: Ka një mungesë të ndërgjegjësimit të grupeve të ndryshme në lidhje me përfitimet që sjell ekonomia qarkulluese. Në këtë kuadër, bizneset si dhe grupet e tjera të interesit perceptojnë që një model i tillë biznesi nuk do t'u sjellë më tepër klientë, duke konsideruar edhe faktin se produktet e prodhuara nga një model i tillë janë më të shtrenjta.

4. VENDE AVANGARDË NË EKONOMINË QARKULLUESE

Duke konsideruar situatën e Shqipërisë në kuadër të integritimit Evropian, kemi vendosur që shembujt e suksesit t'i marrim nga vendet e BE.

HOLLANDA

është në pararojë të ekonomisë qarkulluese në Evropë. Ajo njihet për tërësinë e aktiviteteve dhe iniciativave që ka ndërmarrë në kuadër të avancimit të ekonomisë qarkulluese. Një nga iniciativat më të njohura dhe të rëndësishme të qeverisë holldandeze, është përgatitja e startegjisë kombëtare "Një ekonomi qarkulluese në Holldanë deri në vitin 2050", e cila është zhvilluar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Mjedisit, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, në vitin 2016. Programi përcakton masa që synojnë zhvillimin e një ekonomie qarkulluese deri në vitin 2050 duke përfshirë: objektivin për të zvogëluar përdorimin e lëndëve të para me 50% në vitin 2030 dhe të bëhet gati 100% ekonomi qarkullues deri në vitin 2050. Për më tepër, Holanda ishte i pari vend që prezantoi "Marrëveshjen e Blerjeve Qarkulluese", një iniciativë që nxit bashkëpunimin midis organizatave dhe inkurajon blerjen e produkteve që mund të riciklohen ose përdoren për një kohë më të gjatë. Në përputhje me direktivën e BE për TVSH-në, Holanda gjithashtu ofron ulje të TVSH-së në lidhje me shërbimet e riparimit, veçanërisht për biçikleta, këpucë dhe produktet e lëkurës apo produkte të dorës së dytë.

Në vitin 2017 më shumë se 80 organizata biznesi duke përfshirë edhe qeverinë, nënshkruan një marrëveshje me angazhimin për të kontribuar në strategjinë kombëtare të ekonomisë qarkulluese.

Burimi: <https://ecopreneur.eu/wp-content/uploads/2019/05/Ecopreneur-Circular-Economy-Update-report-2019.pdf>

Rast biznesi në Hollandë

Pakti i plastikës-më shumë produkte plastike por me më pak plastikë.

60 organizata në Hollandë nënshkruan Paktin e Plastikës. Në këtë pakt ata bien dakord që deri në vitin 2025 do të përdorin 20% më pak plastikë dhe do të prodhojnë produkte plastike në atë mënyrë që gjithmonë të mund ta riciklohen. Përveç kësaj, ata do të prodhojnë më tepër plastikë duke përdorur material biologjik për të siguruar më pak mbetje plastike si dhe një mjedis më të mirë dhe më pak emetime të CO2.

Burimi: <https://www.circulairondernemen.nl/library/plastic-pact-nl-mr-met-minder-plastic-1>

FRANCA

ka ecur me hapa progresive nga viti në vit për të kaluar totalisht në një ekonomi qarkulluese. Qeveria franceze publikoi planin e masave në lidhje me ekonominë qarkulluese në Prill 2018, përgatitja e së cilës ishte ndërmarrë nga Ministria për Tranzicion Ekologjik dhe Solidar dhe Ministria për Ekonominë dhe Financave. Ndër masat e ndërmarra, mund të përmenden: krijimin e një etikete riparimi për pajisjet elektro-shtëpiake, përsheptimi i mbledhjes së shisheve plastike dhe kanaçeve, etj. Në këtë kuadër, qeveria po planifikon të vendosë penaltete për ata prodhues të plastikës që prodhojnë produkte me përmbajtje të tillë e cila e bën të pamundur riciklimin dhe një rritje të taksave për groposjen e plehrave në landfille. Nga ana tjetër, do të ofrojë nxitësa tatimore për kompanitë që realizojnë riciklimin e materialeve.

Burimi: <https://ecopreneur.eu/wp-content/uploads/2019/05/Ecopreneur-Circular-Economy-Update-report-2019.pdf>

Graapz është themeluar në korrik 2017. Qëllimi i tij ishte që të mbështeste bizneset vendase në rishitjen e frutave dhe perimeve të tyre që nuk konsideroheshin të freskëta ose estetike dhe për këtë arsye ato nuk mund të ekspozoheshin në raftet e supermarketeve. Duke parë mungesën e mënyrave për t'i dhënë vlerë këtyre produkteve, kjo kompani krijoi një platformë online ku këto produkte mund të shiteshin me një çmim shumë herë më të ulët se ai në supermarkete. Source: <https://www.graapz.com/fr/>

DANIMARKA

ka ndërmarrë iniciativa të koordinuara në lidhje me ekonominë qarkulluese. Në fillimin e vitit 2019, qeveria daneze publikoi "Strategjia mbi Ekonominë Qarkulluese" e cila planifikon një buxhet prej 16 milion Euro për 15 iniciativa që synojnë lehtësimin e kalimit nga ekonomia lineare në atë qarkulluese. Strategjia përqendrohet në riciklimin e materialeve dhe minimizimin e mbeturinave, por gjithashtu i kushton vëmendje eko-inovacionit dhe SME-ve.

Burimi: <https://ecopreneur.eu/wp-content/uploads/2019/05/Ecopreneur-Circular-Economy-Update-report-2019.pdf>

Too Good to Go ka si mision të saj reduktimin sa më shumë të jetë e mundur të mbetjeve ushqimore. Sipas statistikave, një e treta e të gjithë ushqimit të prodhuar kalon në mbetje. Shqetësimi nuk është tek sasia e ushqimit që hidhet por tek burimet që përdoren për të prodhuar këto ushqime: toka, uji dhe puna. E themeluar në Kopenhagen në vitin 2015, To Good To Go u lejon njerëzve të blejnë ushqimin e mbetur që nuk është shitur nga restorantet, kafenetë, supermarketet apo dhe furrat e bukës, me një çmim shume herë më të lirë. Për këtë, kompania ka ndërtuar një aplikacion që ndihmon në koordinimin dhe organizimin e të gjithë procesit.

BRITANIA E MADHE

ka bërë një avancim në lidhje me ekonominë qarkulluese, edhe pse nuk ka një strategji të shkruar. Megjithatë, EQ është inkorporuar në strategjinë industriale e cila njihet me emrin "Ndërtimi i një Britanie të përshtatshme për të ardhmen". UK ka ndërmarrë një sërë iniciativash që nxisin zhvillimin e ekonomisë qarkulluese. Së pari, Fondacioni Ellen MacArthur është i vendosur në UK dhe njihet si një nga organizatat me ndikim të konsiderueshëm në fushën e ekonomisë qarkulluese. Në vitin 2018 ky fondacion ndërmorri nismën e titulluar "Ekonomia e Re e Plastikës" ku bashkoi 250 organizata që firmosën një pakt tejet të rëndësishëm i cili kishte si qëllim angazhimin e të gjithë aktorëve në riprojektimin e plastikës dhe mënyrës sesi ajo përdoret në aktivitetet e biznesit.

Burimi: <https://ecopreneur.eu/wp-content/uploads/2019/05/Ecopreneur-Circular-Economy-Update-report-2019.pdf>

Rast biznesi në Britaninë e Madhe

Aeropowder është një kompani e cila njihet për idenë e saj inovative. Modeli i tyre i biznesit nisi nga një problem që lidhej me mbetjet e shumta nga rritja e pulave. Sipas të dhënave, numri mesatar ditor i pulave të konsumuara është 134 milion. Në total industria e shpendëve gjeneron rreth 10,000 ton pendë në ditë që në fakt konsiderohen në formën e mbetjeve. Pendët përbëhen nga keratina, një proteinë kimikisht rezistente dhe fizikisht e fortë. Falë strukturës së tyre mikroskopike, ato janë një nga fibrat natyrale më të lehta në natyrë dhe janë gjithashtu izolues termik të shkëlqyeshëm. Për këtë, u themelua kjo kompani e cila ka si mision krijimin e materialeve të dobishme nga mbetjet e shpendëve. Pra, ekziston një treg i madh ku mbetjet e shpendëve mund të përfshihen në një ekonomi qarkulluese. Kompania është themeluar në vitin 2016 dhe falë kësaj ideje inovative, ka marrë një mbështetje të madhe. Burimi: <https://www.aeropowder.com/>

SITUATA E EKONOMISË QARKULLUESE NË SHQIPËRI

Fillesa dhe nocione të përafërta me ekonominë qarkulluese

Manaxhimi i integruar i mbetjeve dhe diferencimi i tyre në mënyrë të organizuar vlerësohet se i ka fillësat ligjore në Shqipëri në vitet '60, por mendohet se është një proces më i herët. Industrializimi i vendit, nevoja për lëndë të para, tendenca e sigurimit të burimeve alternative për lëndë të parë, ulja e kostove dhe interesi i përgjithshëm vlerësohet se kanë qenë disa prej arsyeve kryesore se pse në Shqipërinë e atyre viteve pati një manaxhim të integruar të mbetjeve; ku parashikohej riciklimi e ndarja në burim nga popullsia në tërësi.

Në atë periudhë nuk mund të themi se kemi të bëjmë me një politikë pro mjedisit apo me një industri të zhvilluar riciklimi por vetëm me një zgjidhje të pastër ekonomike që reflekton mangësitë që kishte vendi në produkte dhe në lëndë të parë si dhe në politikën për uljen e kostove në maksimum. Një rëndësi e veçantë i është dhënë edhe ndarjes së mbetjeve në burim duke përfshirë në këtë proces jo vetëm familjet shqiptare por edhe njësitë tregtare, ndërmarrjet e transportit etj..

Para viteve '90 familjet shqiptare do të stimuloheshin për të bërë ndarjen e mbetjeve në burim, duke diferencuar kryesisht letrën, kartonin dhe qelqin. Ky fakt mbase mund të konsiderohet si një nga elementët e paktë kapitalist në Shqipëri, për faktin se këto kategori mbetjesh familjet shqiptare mund t'i dorëzonin në pika të caktuara duke u shpërblyer me mjete monetare.

Mungesa e një mbështetjeje ekonomike nga jashtë dhe shkëputja e marrëdhënieve ekonomike me vendet e tjera do të sillnin një rishikim tërësor të politikës ekonomike në vend. Regjimi i kursimit do të ishte edhe politika kryesore që të zbatohet nga popullsia, ndërmarrjet dhe institucionet e tjera shtetërore. Në këto kushte, do të ndryshonin edhe ligjet për prodhimin dhe përdorimin e ambalazheve, ku gjithashtu do të aplikohet një regjim kursimi e nga ana tjetër do të sillte forcimin e praktikës së ndarjes së mbetjeve në burim. Në këtë periudhë mund të thuhet se thuajse çdo mbetje riciklohet.

Në këtë kuadër, mbetjet e drurit do të përdorshin për mobilitetë, mbetjet e plastikës për veshmbathje ndërsa mbetjet e metaleve do t'i nënshtroheshin ripërpunimit me qëllim përfitimin e produkteve të reja. Mbetjet ushqimore do të përdorshin për bujqësinë pasi i nënshtroheshin përpunimit për t'u kthyer në pleh.

Trajtimi i diferencuar për ambalazhet

Ambalazhet ndaheshin në disa kategori; ambalazh kryesor që ripërdorej vazhdimisht dhe ambalazh që përdorej për riciklim. Ambalazhet që përdorshin për paketim konsideroheshin tubat e pastave të dhëmbëve dhe të rrojës, shishet e pijeve alkoolike të parfumeve dhe barnave, kutitë e konservave të ndryshme si dhe sendet me të cilat paketoeshin mallrat.

Mbas vitit 1990 dhe sidomos aktualisht menaxhimi i integruar i mbetjeve ka marr një rëndësi të madhe me rritje të investimeve por edhe i shoqëruar me një serë problemesh dhe kundërshtish për metodat e përdorura.

Riciklimi

Është procesi i shndërrimit të materialeve të mbeturinave në materiale dhe objekte të reja. Është një alternativë për përdorimin e mbeturinave "konvencionale" që mund të kursejnë materiale dhe të ndihmojnë në uljen e emetimeve të gazrave serrë.

Riciklimi mund të parandalojë humbjen e materialeve potencialisht të dobishëm dhe të zvogëlojë konsumin e lëndëve të para të freskëta, duke zvogëluar kështu: përdorimin e energjisë, ndotjen e ajrit (nga djegia) dhe ndotjen e ujit (nga depozitimi). Riciklimi është një përbërës kryesor i zvogëlimit të mbeturinave moderne dhe është komponenti i tretë i hierarkisë së mbeturinave "Ulja, ripërdorimi dhe riciklimi".

Materialet e riciklueshme përfshijnë shumë lloje qelqi, letre, kartoni, metali, plastike, goma, tekstile, bateri dhe elektronikë. Kompostimi ose ripërdorimi tjetër i mbeturinave të biodegradueshme - të tilla si ushqimi ose mbeturinat e tjera është gjithashtu një formë riciklimi. Materialet që do të riciklohen dërgohen në një qendër riciklimi, pastaj klasifikohen, pastrohen dhe ripërpunohen në materiale të reja të destinuara për prodhimin e produkteve të reja.

Riciklimi në Shqipëri është një proces që i ka fillimet që në periudhën e regjimit komunist. Në atë periudhë riciklimi është konsideruar si një mënyrë për uljen e kostove në ndërmarrjet shtetërore e për rrjedhojë stimulohej ripërdorimi i tyre i vazhdueshëm deri në momentin kur ktheheshin në lëndë të parë dhe ricikloheshin sërish.

Në atë periudhë nuk mund të thuhet se ka pasur një politikë pro mjedisit dhe pro riciklimit por ajo që mund të evidentohet është se modeli i riciklimit i përdorur në Shqipërinë e atyre viteve i dedikohej më së shumti faktorëve ekonomikë. Gjithsesi, riciklimi në Shqipërinë e atyre viteve është konsideruar një aktivitet kryesisht për arsye leverdisshmërie ekonomike pasi vetëm në vitet e mëvonshme do të niste të konsiderohej edhe si një proces pro mjedisit.

Riciklimi mbas vitit 1990 dhe sidomos në periudhën e sotme është zgjeruar shumë. Bazuar në nevojën për zhvillim është krijuar Shoqata e Ricikluesve të Shqipërisë në 8 mars 2007 dhe aktualisht përbëhet nga 16 kompani nga sektorë të ndryshëm të industrisë së riciklimit si metalet 4 kompani, letra 1, plastika 9, letër&metal&plastilë 1 dhe plastikë dhe dru 1. Misioni i shoqatës është zhvillimi i industrisë së riciklimit dhe mbrojtja e mjedisit nëpërmjet përfaqësimit, promovimit dhe mbrojtjes së interesave të anëtarëve të saj.

Prodhimi i artikujve të imët

Në vitet e fundit të regjimit komunist sidomos pas viteve 80 u zhvillua një lloj i ri aktiviteti që mund të themi se ishte fillesa e ekonomisë qarkulluese në Shqipëri. Ndërmarrjet e ndryshme nën presionin e mungesës së lëndës së parë dhe të rentabilitetit të ulët me qëllim që të mbijetonin por edhe me propogandën e rritjes së numrit të artikujve që i ofronin popullsisë, filluan të prodhojnë produkte të vogla (të imta) duke përdorur mbeturinat e prodhimit bazë të tyre. Këto produkte u quajtën artikuj të imët dhe bile u hapën edhe njësi tregtare që tregtonin vetëm këto lloj artikujsh. Si artikuj të till mund të përmendim figurina të vogla si tip zbukurimesh artistike prej kompesate dhe druri, produkte të vogla shtëpiake me mbeturina tekstili dhe metalesh e llamarine etj.

Pra, themi fillesat sepse qëllimi bazë nuk ishte ekonomia qarkulluese, nocion që atëherë as që nuk njihej në Shqipëri por nevoja e mbijetesës ekonomike dhe e zënies së njerëzve në punë.

Gjithsesi, duhet të theksojmë se ato nuk patën ndonjë sukses të madh jo vetëm për shkak të periudhës së shkurtër kohore që ekzistuan (me pak se 10 vjet) por edhe si pasojë e nevojave të vogla të tregut për këto produkte dhe varfërisë ekstreme të familjeve shqiptare në vitet e fundit të diktaturës komuniste.

A large, light blue graphic of the number '06.' is positioned on the left side of the page, partially overlapping the text.

06.
**RASTET E APLIKIMIT TË EKONOMISË
QARKULLUESE NË SHQIPËRI**



Sektori i përpunimi të mishit

Sektori i përpunimit të mishit në Shqipëri, ka ofruar mundësi rritje në tregun lokal. Me gjithë trendin rritës, kompanitë po përballen me sfida të shumta në përpjekjet e tyre për të kaluar përtej kufijve. Disa nga problematikat kryesore lidhet me mungesën e njohjes së sistemit veterinar nga institucionet e BE-së. Gjithashtu, tregjet e tregëtimit të mishit në Shqipëri (janë rreth 40 të tillë), nuk respektojnë standardet e cilësisë. Përveç kësaj, Shqipëria ka akoma probleme me gjurmueshmërinë dhe kontrollin e lëvizjes së kafshëve. Progres Raporti i BE-së shpreh qartë shqetësimin në lidhje me kuadrin ligjor dhe institucional për sistemin e sigurisë ushqimore në vend. Megjithë problemet e këtij sektori, përsëri ekzistojnë kompani që punojnë me standard evropiane dhe që kanë hyrë në tregun evropian. Një rast i tillë, përshkruhet si më poshtë.

Rasti 1
I.N.C.A. NORDFISH **Rreth kompanisë** I.N.C.A. NORDFISH Sh.p.k u themelua në vitin 2004 në qytetin e Lezhës. NORDFISH është e vetmja kompani në Shqipëri dhe rajonin e Ballkanit që prodhon dhe shet zorrë të përpunuar dhe produkte me origjinë shtazore nën markën tregtare "INCA: Natural Casings". Kjo kompani furnizon kompanitë më të mëdha shqiptare të mishit. Për më tepër, eksporton në vendet e Ballkanit dhe më gjerë. Një sasi e konsiderueshme e fitimit të kompanisë rinvestohet rregullisht në blerjen e pajisjeve moderne. Si pasojë, nga viti në vit vëllimi i produkteve të saj po rritet. Kompania operon me kapacitet të plotë me numrin e të punësuarve 110, me planin e zgjerimit për të dyfishuar kapacitetin aktual.

Drejtë një modeli biznesi qarkullues

Për shkak të natyrës shumë delikate të zorrëve të kafshëve (p.sh. nganjëherë atyre u mungon madhësia e duhur sipas standardeve të klientëve të huaj, nganjëherë ato kanë vrima që i bën ata të mos jenë të dobishëm për procesin e prodhimit), kompania ishte e detyruar t'i "hidhte". Kjo shkaktonte dëm ekonomik.

Në këto rrethana, pronari dhe djali i tij i madh që është diplomuar në biznes ndërkombëtar në Gjermani, vendosën të udhëtojnë në Evropë dhe të shohin se si menaxhohen këto shqetësime nga bizneset e tjera që operojnë në të njejtën industri. Ata u njohën me praktikën më të mirë në Evropë, por duheshin investime të reja teknologjike për të sjellë këtë ide të vërtetë në Shqipëri. Nëpërmjet investimeve teknologjike, kompania grumbullonte 80% të humbjeve nga të brendshmet e kafshëve dhe i përdorte për të prodhuar një produkt të ri krejt tjetër: Ushqim për kafshët. Këto produkte finale kompania i eksporton në Belgjikë.




Figura 2: Modeli i biznesit tek I.N.C.A. Nordfish Sh.p.k

Sektori i bimëve medicinale

Sektori i bimëve medicinale në Shqipëri cilësohet si kontribuesi i dytë i eksporteve bujqësore (INSTAT). Ky sektor paraqet një potencial të madh zhvillimi. Statistikat tregojnë se janë rreth 100,000 familje në të gjithë vendin të angazhur në këtë sektor, të cilët, të cilat sigurojnë nga aktiviteti i vjeljes dhe grumbullimit një pjesë të madhe të të ardhurave. Rreth 95% e prodhimit të përgjithshëm të bimëve medicinale në vend, prodhohet për eksport dhe kjo përfaqëson rreth 20% të të gjithë eksporteve bujqësore në vend. Në total numurohen rreth 35 kompani përpunuese në këtë sektor, nga të cilat 15 cilësohen si eksportuesit më të mëdhenj.

Rasti 2 ALBKALUSYAN

Rreth kompanisë Albkalusyan është themeluar në vitin 1991 dhe është kompani lider në sektorin e bimëve medicinale. Në vitin 2014, kompania u bashkua me kompaninë lider amerikane, Kalustyan dhe ndryshoi emrin nga Xherdo në Albkalusyan. Kompania grumbullon dhe eksporton më shumë se 26 lloje bimësh medicinale dhe esenca vajore. Aktiviteti themelor i biznesit të saj është grumbullimi dhe eksporti i bimëve mjeksore, me rreth 2.500 ton/vit.

Drejtë një modeli biznesi qarkullues

Gjatë procesit të prodhimit, kompania u përball me një sasi të madhe humbje në formën e kërcejve, etj. Më konkretisht, të gjitha bimët mjeksore dhe aromatike të mbledhura kalojnë nëpër një proces pastrimi dhe pas disa hapash, vetëm 1,500 ton/vit i plotësojnë standardet e cilësisë për eksport. Pjesa e mbetur, përdoret për të prodhuar esenca. Nga përdorimi i këtyre mbetjeve prej 1,000 ton/vit nga bimët medicinale, kompania është në gjendje të prodhojë 30 ton esenca. Ndërsa bëhet procesi i pastrimit të bimeve, kompania përballlet me mbeturina (bimë dhe kërcell). Përveç kësaj, gjatë prodhimit të 30 tonë esenca firma ka rreth 6-7 ton mbeturina. Për të shmangur këtë sasi të madhe humbje, kompania vendosi që të investonte në teknologji. Ajo projektoi dhe ndërtoi një kaldaje e cila i shndërron këto mbetje në avull që plotëson nevojat e fabrikës. Në këtë proces përdoren rreth 50% e mbetjeve.




Figura 3: Modeli i biznesit tek Albkalusyan

Sektori i prodhimit të vezëve

Sektori i prodhimit të vezëve në Shqipëri ka patur një rritje të ndjeshme vitet e fundit. Megjithatë, rritja e konkurrencës (duke përfshirë edhe atë të pandershme) i ka vendosur kompanitë në vështirësi. Sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së Bujqësisë, prodhimi i vezëve në total për 2018-n shënoi rritje modeste prej 2% krahasuar me vitin 2017. Durrësi llogaritet të jetë qarku me nivelin më të lartë të prodhimit e cila shpejgohet edhe me dislokimin e prodhuesve më të mëdhenj në vend. Për vitin 2017, AIBA kishte pjesën më të madhe të tregut me një qarkullim mbi 1 miliard lekë. Megjithatë, ritmi i prodhimit të vezëve ka qenë në rënie për shkak të mbingarkesës në treg si dhe konkurrencës së pandershme.

Rreth kompanisë Aiba Company sh.a u krijua në vitin 1994 si një kompani me drejtim kryesor të aktivitetit prodhimin e ushqimeve blektorale dhe që nga viti 1999 edhe rritjen intensive të shpendëve për prodhim vezësh. Aiba Company sh.a sot ka siguruar pozicionin e liderit në industrinë e prodhimit të vezëve në Shqipëri, jo vetëm në saj të arritjeve të sotme, por veçanërisht në saj të rrugës që ka ndjekur për të ardhur deri këtu.

Drejtë një modeli biznesi qarkullues

Kompania prodhon 100 milion kokra vezë në vit. Mbetjet janë 40 ton në ditë me 80% lagështi. Kompania ka ndërtuar një linjë ku mbetjet thahen duke u vogëluar lagështia nga 80% në 35-40% dhe duke prodhuar kështu rreth 20 ton pleh në ditë të cilat ambalazhohen dhe shiten në thasë. Transformimi i mbeturinave në një produkt komercial, e ka kanalizuar kompaninë në një mënyrë të re të të bërit biznes. Të gjithë plehrat e paketuara u shiten fermerëve të ndryshëm, të cilët kryesisht janë të vendosur në Lushnje dhe Divjakë.




Figura 4: Modeli i biznesit tek AIBA shpk.

Industria e riciklimit

Industria e riciklimit njohu një zhvillim të madh në Shqipëri mbas viteve '90, më së shumti me sipërmarrje të grumbullimit e përpunimit të metaleve, plastikës dhe letrës. Pavarësisht zhvillimit sporadik të hershëm, ajo u shoqërua dhe me investime të rëndësishme teknologjike duke e shndërruar një sektor të organizuar. Sot, ky sektor përfaqësohet nga 60 kompani ku në total investimi i tyre shkon rreth 200 milionë Euro. Në terma punësimi, ky sektor angazhon 3 mijë punonjës në mënyrë direkte dhe 40 mijë të punësuar në mënyrë indirekte. Në këtë sektor, ka një numër të madh kompanish që konsiderohen si eksportuesit më të mëdhenj në Ballkan. Disa nga produktet më të rëndësishme që dalin nga ky sektor përfshijnë: prodhimi i hekurit për ndërtim, lingota alumini dhe profile alumini për industrinë e automobilave. Në këtë sektor ka kompani të cilat riciklojnë mbetje të makinave si dhe materialeve elektrike dhe i eksportojnë ato në BE.

Rasti 4
GER.ARD.

Rreth kompanisë GER.ARD. Shpk është themeluar në vitin 1999. Kohët e fundit, kompania është përqendruar në shërbimet e çmontimit të automjeteve të përdorura, pjesë këmbimi për makina dhe gjithashtu, import dhe eksport. Kompania zotëron pajisjet e nevojshme dhe teknologjinë e fundit për të siguruar çmontimin e plotë të makinave të vjetra. Demontimi kryhet në ambientet e tyre.

Rreth kompanisë IB Recycling është një kompani riciklimi e cila ofron shërbimet e saj për disa vjet në fushën e riciklimit të pjesëve të automjeteve dhe pjesë të ndryshme katalitike të produkteve elektronike. Kompania merret me përpunimin e skrapit elektronik dhe të gjitha mbeturinave të pajisjeve elektronike. Kompania ka në zotrim një infrastrukturë të përshtatshme për shërbimet e riciklimit. IB Recycling është përqendruar për të siguruar riciklimin e plotë të pjesëve të ndryshme të makinës për t'i kthyer ato në materiale prodhuese. Pajisjet kompjuterike dhe katalizatorët e shkarkimit të makinave, pjesë të ndryshme të makinave riciklohen me efikasitet në një nga strukturat më moderne në vend për riciklimin e këtyre produkteve. Aktualisht, kompania ka 20 të punësuar.

Drejtë një modeli biznesi qarkullues

IB Recycling dhe Ger.Ard kohët e fundit kanë krijuar një partneritet biznesi që kërkon t'i zhvendosë ato në një nivel tjetërt të bërit biznes. Sipas përshkrimit të mësipërm, Ger.Ard është më i përqendruar në çmontimin e automjeteve ndërsa të gjitha mbeturinat mbështeten në IB Recycling të cilat kryejnë procesin e riciklimit. Gjatë intervistës me përfaqësuesin e I.B Recycling, u theksua se kompania i shet produktet e ricikluara në Itali, Zvicër dhe Gjermani me rreth 80 tonë në vit.




Figura 5: Modeli i biznesit tek Ger.Ard. shpk.

Pastrimi i detit nga mbetjet e anijeve

Grumbullimi i mbetjeve të ngurta dhe hidrokarbure që dorëzojnë anijet detare që prekin portin detar të Durrësit ka qenë një shërbim që deri në vitin 15.11.1991 ka funksionuar si shërbim mbështetës nga ndërmarrjet e portit detar, kjo edhe për të gjitha portet e vendit. Ky shërbim ishte i organizuar në kuadrin e të gjitha shërbimeve të tjera që kryente ndërmarrja shtetërore Porti Detar sipas prioriteve përkatëse të vendit. Shërbimi konsistonte kryesisht në grumbullimin e mbeturinave që dorëzonin anijet në kalatë sipas standarteve të kodit detar ndërkombëtar dhe ishte i organizuar sipas teknologjisë së kohës duke grumbulluar kryesisht plehrat e ngurta që dorëzeshin nga anijet. Mbas vitit 1991 me ndryshimet social ekonomike të vendit edhe ky shërbim ndryshoi rënjësisht dhe bazohet kryesisht në iniciativa private.

Rreth kompanisë Pastrimi Detar shpk. filloi veprimtarinë e saj në 16 Tetor 1991. Në 1991 ndërmarrja kishte 5 punonjës dhe 2 automjete për heqjen e mbeturinave. Në 1993 kishte 8 punonjës, 3 automjete transporti dhe anijen e parë. Në vitin 1994, kompania bëri planin e saj të parë të biznesit në fushën e pastrimit të porteve. Sot kompania ka një fabrikë të ndarjes hidrokarbure që plotëson parametrat e Komunitetit Evropian dhe operon me më shumë se 50 punonjës. Kompania ka investuar gjithnjë e më shumë në teknologjinë më cilësore, e cila synon të shndërrojë sa më shumë që të jetë e mundur të gjitha mbeturinat që ndotin portin e Durrësit. Kjo është arsyeja pse, në vitin 2016 pronari i kompanisë vendosi të aplikoj një projekt të ri.

Drejtë një modeli biznesi qarkullues

Në vitin 2016, kompania investoi në një projekt të ri i cili kishte për qëllim ndërtimin e një stacioni ku do të instalohet një linjë me rezervuare dhe depozita të cilat do të përpunonin ujërat detar të mbledhur nga anijet e ankoruara në portin e Durrësit. Për këtë qëllim, investitori ndërtoi një objekt me një sipërfaqe prej 4760 m², i vendosur në zonën Porto-Romanos të Durrësit dhe investoi në teknologji të re për të bërë këtë gjë.




Figure 6: Modeli i biznesit tek Pastrimi detar shpk.

Prodhimi i sapunit

Punishtja e parë e sapunit në Shqipëri është ngritur më 1897 në Shkodër, ndërsa në vitet 1918 e 1927 u ngritën edhe dy fabrika të vogla. Gjithsej para çlirimit të Shqipërisë kishte 6 fabrika të vogla si dhe 54 punishte artizanale sapuni, në Korçë, Tiranë, Durrës, Elbasan etj. me shkallë shumë të ulët mekanizimi. Në Shkodër prodhohej sapun rrobash, sapun tualeti dhe parfume të ndryshme. Menjëherë pas çlirimit filloi puna për përmirësime teknologjike të industrisë së sapunit. U ngritën fabrika e sapunit në Shkodër, duke përqendruar punishtet e mëparshme, si dhe në Elbasan e Rrogozhinë. Më 1971 në Vlorë u ngrit një fabrikë më e madhe sapuni me teknologji të përparuar dhe e mekanizuar. Deri më 1975 kjo industri përdorte si lëndë të parë yndyrnat asnjënjëse me origjinë bimore e shtazore. Me ngritjen e fabrikës së përpunimit të thellë të yndyrnave industriale në Fier, filloi të përdoret si lëndë e parë edhe acidet yndyrore.

Rreth projektit Roskoveci është një qytet i vogël i cili ndodhet në pjesën jug-qendrore të Shqipërisë. Situata socio-ekonomike e qytetit mbetet problematike. Karakterizohet nga një nivel i lartë papunësie, veçanërisht për gratë. Roskoveci është shumë i pasur me ullinj të cilët familjet kryesisht i përdorin për nevoja të tyre personale dhe për treg. Sidoqoftë, nga përgatitja e vajit të ullirit, krijohen shumë mbetje. Kjo ishte pika fillestare e idesë për të filluar një projekt në Roskovec.

Drejtë një modeli biznesi qarkullues

Në kuadër të "Programit Rajonal të Demokracisë Lokale në Ballkanin Perëndimor, (ReLOaD) i financuar nga Bashkimi Evropian, UNDP në partneritet me BE, po punon në 12 bashki në të gjithë vendin për të rritur partneritetin midis bashkive dhe organizatave të shoqërisë civile për të ofruar më mirë shërbime për qytetarët dhe forcimin e demokracisë vendore. Projekti ka një qëllim të dyfishtë. Së pari, ai synon të forcojë kapacitetet e bashkisë dhe OJF-ve në administrimin e projekteve. Së dyti, ai synon të fuqizojë OJF-të në procesin e integrimit në BE. "Investimi i Zhvillimit Social" (SDI), një OJQ e specializuar në zhvillimin rural dhe fuqizimin e grave përmes integrimit në aktivitetet ekonomike, është zbatuesi i projektit në partneritet me Bashkinë e Roskovecit. Ky projekt po zhvillohet në Roskovec dhe rezultati përfundimtar është prodhimi i sapunit organik përmes shfrytëzimit të mbetjeve të vajit të ullirit.




Figura 7: Modeli i biznesit tek Sapun Organik Roskovec

Projekti i titulluar "Sapun Organik i Roskovecit", filloi në vitin 2018 dhe vazhdon të zbatohet. Bashkia e Roskovecit ka siguruar ambiente falas dhe hapësira u bë qendra e projektit. Ky projekt, i cili përdor mbetjet e vajit të ullirit nga fabrikat lokale të prodhimit ose nga ai vaj ulliri që nuk është për konsum, por mund të ripërdoret për të prodhuar sapun. Kjo punishte ka punësuar tashmë 25 gra që jetojnë në Roskovec. Këto punonjëse, përveç përdorimit të mbetjeve të vajit të ullirit, paketojnë të gjithë sapunët organik në një mënyrë shumë efektive. Ato përdorin një përzierje letre të ricikluar duke i dhënë kështu sapunit një pamje artizanale . Aktualisht, qendra është në gjendje të prodhojë një ton në muaj. Sidoqoftë, aftësia e prodhimit varet nga kërkesa e tregut. SDI tashmë ka filluar të testojë tregun dhe të gjejë mënyra të reja për të shitur produktin. Ky është vetëm fillimi i projektit dhe duhet të sigurohet qëndrueshmëria e idesë. Për këtë qëllim, tashmë është nënshkruar një memorandum bashkëpunimi midis grupit të grave prodhuese, Bashkisë dhe një organizate tjetër lokale. Kjo e fundit do të përpiqet të gjejë treg dhe të shesë produktin. Deri më tani, ata janë duke u përpjekur ta shesin produktin përmes internetit dhe në disa dyqane.

Brookings (2017), "The Unprecedented Expansion of the Global Middle Class: An Update".

World Bank (2019), "Solid Waste Management".

Pearce, D.W. and R.K. Turner (1990), *Economics of Natural Resources and the Environment*, Hemel Hempstead: Harvester Wheatsheaf.

Sauvé, S., S. Bernard and P. Sloan (2016), "Environmental sciences, sustainable development and circular economy: Alternative concepts for trans-disciplinary research", *Environmental Development*, Vol. 17, pp. 48-56.

EEA (European Environment Agency) (2016), "Circular Economy in Europe – Developing the knowledge base", EEA Report No. 2/2016.

Ellen MacArthur Foundation (2013a), "Towards the Circular Economy. Economic and Business Rationale for an Accelerated Transition".

European Commission (2015a), "Closing the loop - An EU action plan for the Circular Economy", Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, COM (2015) 614 final.

Ellen MacArthur Foundation, McKinsey & Company (2014), "Towards the Circular Economy: Accelerating the scale-up across global supply chains".

European Commission (2011), Communication from the commission to the European Parliament, the council, the European economic and social committee and the committee of the regions. Roadmap to a Resource Efficient Europe.

Përgatitur nga:



Me suportin financiar të:



